



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.111**

**12 gusht**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.546, datë 11.8.2011	Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atashëve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë Qendrës SECI, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë .....	4405
Vendim i KM nr.547, datë 11.8.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë të Gardës së Republikës së Shqipërisë” .....	4411
Vendim i KM nr.548, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.718, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të personelit të hetimit, të inspektimit dhe të shërbimeve mbështetëse, në Shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.....	4412
Vendim i KM nr.549, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar .....	4414

Vendim i KM nr.550, datë 11.8.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar .....	4417
Vendim i KM nr.551, datë 11.8.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar .....	4418
Vendim i KM nr.552, datë 11.8.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.455, datë 18.7.2007 “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor”, të ndryshuar .....	4422

**VENDIM**  
**Nr.546, datë 11.8.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE SHITESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA, TË ATASHEVE USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PERSONELIT CIVIL TË MINISTRISË SË MBROJTJES QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS PRANË QENDRËS SECI, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI, PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 12.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:
  - 1/1. Personeli diplomatik në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja.
  - 1/2. Personeli administrativo-teknik në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja.
  - 1/3. Ushtarakët shqiptarë, si dhe punonjësit civilë të Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar, për kohën që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare.
  - 1/4. Punonjësit shqiptarë të Ministrisë së Brendshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme.
  - 1/5. Punonjësit shqiptarë të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës, pranë Qendrës SECI.
2. Paga mujore e punonjësve, të përcaktuar sipas pikës 1/1 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  - 2/1. I ngarkuari me punë në përfaqësitë në vendet me të cilat kemi marrëdhënie në këtë nivel, paguhet me gradën e ministrit këshilltar.
  - 2/2. I ngarkuari me punë a.i., paguhet me një gradë më të lartë se ajo që mban, për kohën që ushtron këtë funksion.
3. Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/2 të këtij vendimi, edhe në rastet kur në këto pozicione punësohen shtetas të vendit ku ndodhet përfaqësia diplomatike, të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  - 3/1. PAGESA E PUNONJËSVE TË PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/2 TË KËTJË VENDIMI, NË RASTIN KUR JANË TË PUNËSUAR ME KOHË TË PJESSHME, TË JETË SIPAS LIDHJES NR.2/1, QË I BASHKËLIDHET KËTJË VENDIMI DHE ËSHTË PJESË PËRBËRËSE E TIJ. APLIKIMI I NIVELIT MAKSIMAL APO MINIMAL PËRCAKTOHET NË VARËSI TË NGARKESËS SË PUNËS, ME URDHËR TË PËRBASHKËT TË MINISTRIT TË FINANCAVE DHE MINISTRIT TË PUNËVE TË JASHTME.

3/2. Përcaktimi i pozicioneve administrativo-teknike në përfaqësitë diplomatike, me kohë të plotë apo të pjesshme, deri në miratimin e plotë nga Kryeministri të strukturave të përfaqësive diplomatike, bëhet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

4. Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/3 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Paga e atashet ushtarak nuk mund të jetë më e lartë se ajo e ministrit këshilltar në përfaqësitë diplomatike. Në rastet kur Ministri i Mbrojtjes, në marrëveshje me Ministrin e Punëve të Jashtme, për shkak të ngarkesës së punës, emëron edhe një ndihmës të atashet ushtarak, ky trajtohet jo më shumë se grada diplomatike e këshilltarit të përfaqësisë diplomatike.

4/1. Për punonjësit e përcaktuar sipas pikës 1/3 të këtij vendimi, paga i shtrin efektet nga data e mbërritjes në vendin e punës. Deri në këtë moment vazhdon të paguhet me pagën ekzistuese.

4/2. Punonjësit e përcaktuar sipas pikës 1/3 të këtij vendimi, kur shkojnë për herë të parë në vendin e punës, marrin si paradhënie, në valutë, pagesën e 15 ditëve, të cilën e shlyejnë brenda 6 muajve nga data e fillimit të detyrës. Nëse transferohen në atdhe para mbarimit të këtij afati, kundërvlerën e paradhënies së mbetur e shlyejnë në lekë, sipas kursit të këmbimit valutor, brenda 6 muajve pas kthimit në atdhe.

5. Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/4 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për efekt të këtij trajtimi, paga e këtyre punonjësve njehsohet me pagën e gradës Këshilltar, në shërbimin e jashtëm.

5/1. Për punonjësit e përcaktuar sipas pikës 1/4 të këtij vendimi, trajtimi me pagë sipas këtij vendimi fillon nga data e mbërritjes së tij në përfaqësi. Deri në këtë çast ai vazhdon të trajtohet me pagën e vendit të tij të mëparshëm.

6. Paga mujore e punonjësve të përcaktuar sipas pikës 1/5 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për efekt të këtij trajtimi, paga e këtyre punonjësve njehsohet me pagën e gradës Këshilltar, në shërbimin e jashtëm. Përveç pagës mujore këta punonjës përfitojnë edhe kompensimin për koston e jetesës, në masën 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro.

6/1. Për punonjësit e përcaktuar sipas pikës 1/5 të këtij vendimi, trajtimi me pagë sipas këtij vendimi fillon nga data e mbërritjes së tij pranë Qendrës SECI. Deri në këtë çast, ai trajtohet me pagën ekzistuese të vendit të tij të mëparshëm të punës.

7. Punonjësit e përcaktuar sipas pikave 1/1, 1/3 dhe 1/4 të këtij vendimi, përveç pagës mujore të përcaktuar sipas lidhjeve përkatëse, përfitojnë edhe një kompensim për koston e jetesës, përkatësisht:

- 300 euro/USD për vendet e grupit të parë;
- 260 euro/USD për vendet e grupit të dytë;
- 230 euro/USD për vendet e grupit të tretë;
- 200 euro/USD për vendet e grupit të katërt;
- 150 euro/USD për vendet e grupit të pestë.

8. Kategorizimi i përfaqësive, për efekt të përfitimit të koston së jetesës për:

a) punonjësit e përcaktuar sipas pikës 1/1 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) punonjësit e përcaktuar sipas pikës 1/3 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) punonjësit e përcaktuar sipas pikës 1/4 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Paga mujore e punonjësve që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi. Në bazë të saj do të paguhet edhe detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

10. Paga mujore e punonjësve që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi i nënshtrohet rishikimit në të njëjtën formë si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

11. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.495, datë 1.8.2007 “Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja”, i ndryshuar, nr.90, datë 28.1.2008 “Për pagat e atashëve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare”, i ndryshuar, nr.932, datë 2.7.2008 “Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve shqiptarë, për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nr.1315, datë 1.10.2008 “Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë Qendrës SECI”, i ndryshuar, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/1 TË KËTIJ VENDIMI**

Pozicioni	Paga mujore	
	1	2
	Paga bazë mujore (në euro dhe dollarë USD)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Ambasador	1275 euro 1550 dollarë USD	75%
Konsull i Përgjithshëm; Ministër Fuqiplotë; Ministër Këshilltar	980 euro 1180 dollarë USD	75% 40% 40%
Këshilltar	820 euro 1040 dollarë USD	40%
Sekretar i Parë; Konsull	675 euro 830 dollarë USD	40%
Sekretar i Dytë; Zëvendëskonsull	530 euro 675 dollarë USD	40%
Sekretar i Tretë; Agjent Konsull	480 euro 590 dollarë USD	40%
Atashe	430 euro 530 dollarë USD	40%

**PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/2 TË KËTIJ VENDIMI  
(NË RASTIN KUR JANË TË PUNËSUAR ME KOHË TË PLOTË)**

Pozicioni	Paga mujore				
	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
Sekretar Teknik; Financier; Specialist	835 euro 935 dollarë USD	800 euro 900 dollarë USD	765 euro 870 dollarë USD	740 euro 845 dollarë USD	685 euro 800 dollarë USD
Shofer	800 euro 900 dollarë USD	755 euro 855 dollarë USD	720 euro 825 dollarë USD	695 euro 805 dollarë USD	640 euro 750 dollarë USD
Kafaz	665 euro 730 dollarë USD	630 euro 700 dollarë USD	600 euro 670 dollarë USD	570 euro 640 dollarë USD	530 euro 590 dollarë USD

**PAGESA MUJORE E PUNONJËSVE TË PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/2 TË KËTIJ  
VENDIMI (NË RASTIN KUR JANË TË PUNËSUAR ME KOHË TË PJESSHME)**

Pozicioni	Paga mujore (me kohë të pjesshme)	
	minimumi	maksimumi
Sekretar Teknik; Financier; Specialist	305 euro 335 dollarë USD	465 euro 520 dollarë USD
Pastrues	235 euro 255 dollarë USD	315 euro 345 dollarë USD

**PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/3 TË KËTIJ VENDIMI**

Emërtimi	Paga në euro	Paga në dollarë	Shtesa për përfaqësimin (në %)
<b>Përfaqësitë e NATO-s</b>			
Gj. Lejtnant	1190	1440	75%
Gj. Major	1170	1390	60 – 75%
Gj. Brigade	1090	1310	60 – 75%
<b>Përfaqësitë e tjera</b>			
Kolonel	980	1190	40 – 60%
Nënkolonel	930	1120	40 – 60%
Major	880	1070	40%
Kapiten	820	1040	40%
Toger	775	945	40%
Nëntoger	720	890	40%
K/kapter	775	945	40%
Kapter	695	835	40%

Rreshter	590	695	40%
Tetar	480	585	40%
Nëntetar	430	530	40%

Lidhja nr.4

PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/4 TË KËTIJ VENDIMI

Pozicioni	Paga mujore	
	Paga bazë mujore (në euro dhe në dollarë)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Oficer kontakti	820 euro 1040 dollarë USD	40%

Lidhja nr.5

PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/5 TË KËTIJ VENDIMI

Pozicioni	Paga mujore	
	Paga bazë mujore (në euro)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Nëpunës ndërlidhës	820 euro	40%

Lidhja nr.6

KATEGORIZIMI I PËRFAQËSIVE PËR EFEKT TË PËRFITIMIT TË KOSTOS SË JETESËS PËR PUNONJËSIT E PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/1 TË KËTIJ VENDIMI

Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
1. Misoni NY 2. Konsull NY 3. Londër 4. Gjenevë 5. Kopenhagën 6. Berne 7. Moskë 8. Pekin 9. Tokio 10. Milano 11. Stamboll	1. Vjenë 2. Misioni OSBE 3. Uashington 4. Paris 5. Romë 6. Strasburg 7. Berlin 8. Madrid 9. Otava 10. UNESKO 11. Vatikan	1. Bruksel 2. Nato 3. Athinë 4. Ankara 5. Hagë 6. Stokholm 7. Varshavë 8. Budapest 9. Pragë 10. Beograd 11. Selanik 12. Tel-Aviv	1. Zagreb 2. Kajro 3. Janinë 4. Bari 5. K. Lumpur 6. Riad	1. Shkup 2. Prishtinë 3. Sofje 4. Podgoricë 5. Buenos Aires 6. Bukuresht

**KATEGORIZIMI I PËRFAQËSIVE PËR EFEKT TË PËRFITIMIT TË KOSTOS SË JETESËS  
PËR PUNONJËSIT E PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/3 TË KËTIJ VENDIMI**

<b>Grupi 1</b>	<b>Grupi 2</b>	<b>Grupi 3</b>	<b>Grupi 4</b>	<b>Grupi 5</b>
1. Londër 2. Gjenevë 3. Moskë	1. Vjenë 2. Uashington 3. Paris 4. Romë 5. Berlin 6. Madrid 7. Napoli 8. Oberamergau 9. Brunsum 10. Florida SHBA	1. Bruksel 2. Nato 3. Athinë 4. Ankara 5. Hagë 6. Stokholm 7. Varshavë 8. Budapest 9. Mons	1. Zagreb 2. Izmir	1. Shkup 2. Bukuresht

**KATEGORIZIMI I PËRFAQËSIVE PËR EFEKT TË PËRFITIMIT TË KOSTOS SË JETESËS  
PËR PUNONJËSIT E PËRCAKTUAR SIPAS PIKËS 1/4 TË KËTIJ VENDIMI**

<b>Grupi 1</b>	<b>Grupi 2</b>	<b>Grupi 3</b>	<b>Grupi 4</b>	<b>Grupi 5</b>
1. Londër 2. Gjenevë 3. Kopenhagën 4. Berne 5. Moskë 6. Pekin 7. Tokio 8. Milano 9. Stamboll	1. Vjenë 2. Uashington 3. Paris 4. Romë 5. Strasburg 6. Berlin 7. Madrid 8. Otava	1. Bruksel 2. Nato 3. Athinë 4. Ankara 5. Hagë 6. Stokholm 7. Varshavë 8. Budapest 9. Pragë 10. Beograd 11. Selanik 12. Tel-Aviv 13. EUROPOL	1. Zagreb 2. Kajro 3. Janinë 4. Bari 5. K.Lumpur 6. Riad	1. Shkup 2. Prishtinë 3. Sofje 4. Podgoricë 5. Buenos Aires 6. Bukuresht



**VENDIM**  
**Nr.547, datë 11.8.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE**  
**NËNOFICERË TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Lidhja nr.1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave për vitin 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

**NIVELI I PAGËS PËR GRADË SIPAS ROLEVE PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË**  
**REPUBLIKËS**

<b>Roli i punonjësve sipas gradave</b>		<b>Grada</b>	<b>Paga bazë për gradë</b>	
Për punonjësit oficerë	Madhor	Gjeneral garde	109100	
		I lartë	Kolonel	94850
			N/kolonel	83600
I mesëm	I mesëm	Major	71400	
		Kapiten	60700	
		N/Kapiten	57650	
I ulët	I ulët	Toger	54600	
		N/Toger	51500	
Për punonjësit nënoficerë	Madhor	Kryekapter	43400	
		I lartë	Kapter	41300
			Kapter shtabi	40300
Kapter mjeshtër	39300			
I mesëm	I mesëm	Kapter i parë	38800	
		Kapter i dytë	38250	
		Kapter i tretë	37750	
I ulët	I ulët	Kapter i katërt	37000	
		Rreshter	35900	

**VENDIM**  
**Nr.548, datë 11.8.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.718, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË**  
**INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE, NË SHËRBIMIN E**  
**KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 51 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme” dhe në ligjin nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.718, datë 23.6.2009, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit civilë inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.3, e përmendur në pikën 8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES**  
**TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM**

<b>Nr.</b>	<b>Grada</b>	<b>Funksionet organike</b>	<b>Paga bazë për gradë</b>	<b>Shtesa për natyrë të veçantë pune</b>
	1	2	3	4
1	Asistent	Ndihmësspecialist në provë në trupën operacionale	36500	6500
2	Agjent	Ndihmësspecialist në trupën operacionale	40000	8000
3	Agjent I	Drejtues grupi/ ndihmësspecialist në trupën operacionale	45000	8000
4	Hetues	Specialist hetimi në nivel vendor; Specialist hetimi në nivel vendor në provë	55000	8000
5	Hetues I	Specialist hetimi në nivel vendor	68000	8000
	Hetues I	Specialist hetimi në nivel qendror;	76800	10000

		Shef seksioni në nivel qendror; Shef sektori në nivel vendor		
6	Drejtues	Shef seksioni në nivel qendror; Shef sektori në nivel vendor; Shef sektori në nivel qendror	83800	10000
7	Drejtues I	Shef sektori në nivel qendror; Drejtor drejtorie në nivel vendor; Drejtor drejtorie në nivel qendror	94900	10000
8	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm (Drejtor i Departamentit të Hetimit)	97900	15000
9	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	107100	20000

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË INSPEKTUES DHE MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM**

Nr.	Klasifikimi i niveleve	Funksionet organike	Kategoria e pagës	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa e pozicionit	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4	5	6	7
1	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit	II-b	1	2%	89800	
2	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor në nivel qendror (për shërbimet mbështetëse)	III-a	1	2%	72500	
3	Punonjës të nivelit bazë drejtues	Shef sektori në nivel qendror (në drejtorinë e inspektimit)	III-a	1	2%	72500	5000
4	Punonjës të nivelit bazë zbatues	Inspektor në nivel qendror (në drejtorinë e inspektimit)	III-b	1 ose 2	2%	55100	5000
		Specialist në nivel qendror	III-b	1 ose 2	2%	55100	
		Specialist trajnimi në nivel qendror për punonjësit e SHKB-së	IV-a	1 ose 2	2%	43900	5000
		Specialist në nivel qendror	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	43900	
		Specialist në nivel qendror	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	33700	

## VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND); Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND); Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	13000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP); Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10000 lekë

## VENDIM

Nr.549, datë 11.8.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË  
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 12.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Masa e shtesës për natyrë të veçantë që përfitojnë ushtarakët në Forcat e Armatosura”, e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit, për rritjen e pagave për vitin 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

	Vitet e shërbimit														
<b>OFICERË</b>	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj.Lejtnant (admiral)															155000
Gj.Major (nënadmiral)														145000	148000
Gj.Brigade (kundëradmiral)												115000	116000	116000	
Kolonel (kapiten i rangut I)										91000	92500	94500	96400	98000	
Nenkolonel (kapiten i rangut II)								71700	73100	74350	75650	76800	78200	79400	
Major (kapiten i rangut III)							56250	57350	58300	59300	61100	62650	63500		
Kapiten (kapiten lejtnant)				50350	51000	51650	52300	52950	53550	54230	54850				
Toger (lejtnant)			46600	47960	48700	49800	50350								
Nëntoger (nënlejtnant)	42500	43400	44200	45000	45700	46600									
	Vitet e shërbimit														
<b>NËNOFICERË</b>	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/Kapter											51400	52500	54100	55200	56250
Kapter								43700	45200	45990	46600	48200	50350		
Rreshter						38350	40000	42400	43700	45200	45990				
Tetar				36350	37320	37850	38700	39480	40350	41300	42100				
Nëntetar	31360	32000	33320	34600	36350	37650									
	Vitet e shërbimit														
<b>USHTARË PROFESIONISTË</b>	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/ detar profesionist II	31260	32550	33850	35175	36340										
Ushtar/ detar profesionist I	28700	29970													
<b>USHTARË TË SHËRBIMIT TË DETYRUESHËM E STUDENTË USHTARAKË</b>															
	Vitet e shërbimit														
	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/ detar II	2000														
Ushtar rekrut I/ detar I	1500														
Studentë ushtarakë	1500														

**MASA E SHITESËS PËR KUSHTE TË VEÇANTA PUNE E SHËRBIMI QË PËRFITOJNË  
USHTARAKËT AKTIVË NË FA**

Nr.	Personeli ushtarak që përfiton shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi	Masa e shtesës (në lekë)
1	<p>Mjekët që shërbejnë në FA; Pilotët e emëruar në pozicionet organike që kërkojnë kryerjen e fluturimeve; Parashutistët; Oficerët apo nënoficerët në detyrë dhe në kualifikimi si zhytës; Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë të kualifikuar që shërbejnë në njësitë e Asgjësimit me Eksploziv të Municioneve dhe që kryejnë operacione për shkatërrimin e municioneve dhe eksplozivëve; Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë të emëruar në Batalionin Special Komando, të cilët kryejnë detyra taktike të Batalionit Special; Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë të emëruar në Batalionin Komando, që kryejnë detyra taktike komando; Personeli ushtarak radiozbulues i Qendrës së Radiozbulimit që shërben në repartet Kroi i Bardhë-Kukës, Tarabosh-Shkodër, Çardhak-Korçë dhe Mali i Krujës</p>	8000
2	<p>Personeli ushtarak administrativ dhe ai i ndihmës, të emëruar në Batalionin Special Komando, por që nuk kryejnë detyra taktike të Batalionit Special Komando; Personeli ushtarak administrativ dhe ai i ndihmës, të emëruar në Batalionin Komando, por që nuk kryejnë detyra taktike të Komando; Oficerët, nënoficerët apo ushtarët profesionistë në Qendrën e Stërviçjes Bazë, që janë emëruar në funksione dhe që kryejnë direkt stërviçjen bazë; Personeli ushtarak i Qendrës së Stërviçjes Bazë deri në nivel Kompanie; Personeli ushtarak në strukturën e Rojës Bregdetare; Personeli tjetër ushtarak i Qendrës së Radiozbulimit që shërben në repartet Kroi i Bardhë-Kukës, Tarabosh-Shkodër, Çardhak-Korçë dhe Mali i Krujës; Personeli ushtarak i Policisë Ushtarake, i cili angazhohet direkt në punën operative dhe funksionale që kryen Policia Ushtarake; Personeli ushtarak deri në nivel kompanie në Forcën Tokësore. Komandantët e batalioneve në Forcën Tokësore; Personeli nënoficer dhe ushtar profesionist, operatorë radiozbulues në strukturat e Qendrës së Radiozbulimit</p>	5000
3	<p>Pilotët e emëruar në pozicione organike që nuk kërkojnë kryerjen e fluturimeve; Personeli mirëmbajtës inxhiniero-teknik i aviacionit. Personeli fluturues teknik e mekanik; Oficerët me specialitete detare të emëruar në pozicione organike, që kërkojnë kryerjen e lundrimeve dhe personeli ushtarak (oficer, nënoficer dhe ushtar profesionist) i emëruar në anije; Personeli ushtarak i Policisë Ushtarake që nuk përfshihet në numrin rendor 2; Personeli i Forcës Tokësore që nuk përfshihet në numrin rendor 2; Personeli ushtarak (drejtimi dhe trupa) në Orkestrën Frymore; Personeli ushtarak i Qendrës së Stërviçjes Bazë që nuk përfshihet në numrin rendor 2; Personeli ushtarak i kompanisë së rikonicionit të Forcave Tokësore. Personeli ushtarak i qendrave të vëzhgimit ajror në Forcat Ajrore. Personeli ushtarak i postave radioteknike dhe postave sinjal-vrojtuese në Forcat Detare; Personeli ushtarak radiozbulues i Qendrës së Radiozbulimit që shërben në strukturat Shtoj, Krujë, Korçë, Kavajë, Sarandë</p>	3000

**VENDIM**  
**Nr.550, datë 11.8.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.748, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE**  
**TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË**  
**LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
    - a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë”, zëvendësohet me lidhjen nr.1 me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
    - b) Në fund të pikës 5, pas fjalëve “... për këtë periudhë”, shtohen fjalët “... dhe jo më shumë se 9 mbledhje në vit...”.
    - c) Në pikën 9, pas fjalëve “... me kontratë ...”, shtohen fjalët “... nga kategoria “Akademik” dhe kategoria “Profesor”...”.
  2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e institucioneve të arsimit të lartë, për vitin 2011.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK,**  
**NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Paga</b>
1	Rektor (titullar institucioni)	127500
2	Zëvendësrektor, nga kategoria “Profesor”	122400
3	Zëvendësrektor, nga kategoria “Docent”	120400
4	Dekan nga kategoria “Profesor”	122400
	Dekan nga kategoria “Docent”	120400
5	Zëvendësdekan, nga kategoria “Profesor”	109150
6	Zëvendësdekan, nga kategoria “Docent”	97000
7	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Profesor”	109150
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Docent”	97000
9	Profesor	105570
10	Profesor i Asociuar	91800
11	Docent	83650
12	Lektor i Parë/Kërkues i parë	80600
13	Lektor/Kërkues	64300

**VENDIM**  
**Nr.551, datë 11.8.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.717, DATË 23.6.2009 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË  
INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE  
BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
  - a) Lidhja nr.I “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës, institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  - b) Lidhja nr.2 “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale dhe vendore”, përmendur në pikën 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  - c) Në lidhjen I/I “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e ministrive të linjës, institucioneve të pavarura e kushtetuese, institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, bëhen këto ndryshime:
    - c/1. Në numrin rendor 6, në klasën VIII pas fjalëve: “...Bibliotekar në Bibliotekën Shkencore të Universitetit”, shtohen fjalët “... dhe të Akademisë së Shkencave”;
    - c/2. Në numrin rendor 8, në klasën VI, shtohet emërtesa: “Magazinier”.
    - c/3. Në numrin rendor 9 në klasën V, emërtesa “Magazinier” shfuqizohet.
  - d) Pas lidhjes I/9, shtohet lidhja I/10 “Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit e Shtëpisë së Pushimit, të Ministrisë së Brendshme, Durrës”.
  - e) Lidhja II/1 “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e institucioneve rajonale dhe vendore, si dhe të institucioneve qendrore, të grupit të tretë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”, e përmendur në pikën 5 të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, për vitin 2011, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT,  
NË KRYEMINISTRI, INSTITUCIONE TË PAVARURA, APARATET E MINISTRIVE TË  
LINJËS, INSTITUCIONE QENDRORE NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË  
LINJËS DHE NË PREFEKTURA

<b>Nr. rendor</b>	<b>Klasa</b>	<b>Paga bazë mujore në lekë</b>
1	I	20000
2	II	21500
3	III	22780
4	IV	23400
5	V	24600
6	VI	26700
7	VII	28500
8	VIII	31500
9	IX	35000
10	X	37000

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET RAJONALE DHE VENDORE

<b>Nr. rendor</b>	<b>Klasa</b>	<b>Paga bazë mujore në lekë</b>
1	I	20000
2	II	21500
3	III	22780
4	IV	23400
5	V	24600
6	VI	25600
7	VII	26200
8	VIII	26600
9	IX	28200
10	X	29500
11	XI	30500
12	XII	32000
13	XIII	33500
14	XIV	35500

**RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT  
MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E SHTËPISË SË PUSHIMIT TË MINISTRISË SË  
BRENDSHME, DURRËS**

<b>Nr.</b>	<b>POZICIONI</b>	<b>KLASA</b>	<b>Shtesa për funksion drejtues</b>	<b>Shtesa për kushte pune</b>
1	Përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)	X	3	5000
2	Përgjegjës (gjelbërimi, aktivitete të tjera ndihmëse)	IX		
3	Kuzhinier, administrues hoteli	VIII		5000
4	Banakier	VIII		
5	Ndihmëskuzhinier	VII		3000
6	Kamerier; Receptionsist	VI		
7	Punonjës hotelerie; Punonjës gjelbërimi	III		
8	Punëtorë kuzhine; Punëtorë restoranti	II		
9	Punëtorë lavanterie	I		

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

**RENDITJA E POZICIONEVE TË PËRGJITHSHME TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR  
PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E INSTITUCIONEVE RAJONALE DHE  
VENDORE, SI DHE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE TË GRUPIT TË TRETË TË  
SISTEMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

<b>Nr.</b>	<b>POZICIONI</b>	<b>KLASA</b>	<b>Shtesa për funksion drejtues, sipas grupit përkatës</b>
	Manovrator i makinerive të rënda	XIV	
	Ndihmësmannovrator i makinerive të rënda	XIII	
	Sekretare në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit; Punonjës i gjendjes civile në bashki	XII	
	Kryetar dege në arsimin parauniversitar; Kryekujdestar në qendrat e përkujdesit social; Përgjegjës ofiçine e transporti; Përgjegjës grupi në Drejtoritë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Drejtorinë e Riparimit të Makinerive të Furnizimit në Tiranë	XI	3
	Punonjës i gjendjes civile në komuna	XI	
	Shofer me automjete speciale; Kryesondist	X	
	Ndihmësspecialist; Meteorolog;	IX	

	<p>Ndihmësmjek;  Laborant;  Sekretar;  Sekretar shkolle në arsimin parauniversitar, në shkollat e mesme;  Kryekuzhinier;  Kryeinfermier;  Farmacist;  Arkivist;  Llogaritar, ekonomist i mesëm;  Shofer automjeti transporti mbi 2.5 tonë dhe mjeteve speciale;  Anketues;  Motopompist</p>		
	<p>Sekretar shkolle në arsimin parauniversitar në shkollat 9-vjeçare;  Arkiviste gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit;  Bibliotekar;  Programist;  Instruktor;  Metodist;  Kujdestar në qendrat e përkujdesit social;  Shofer transporti me automjet mbi 2.5 tonë;  Administrator i sistemeve të ndërlidhjes;  Palombar</p>	VIII	
4.	<p>Teknik i mirëmbajtjes së pajisjeve tokësore, ajrore, detare, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes;  Minator;  Ndërlidhës;  Piktor;  Dizenjator;  Punonjës sekretarie</p>	VII	
5.	<p>Teknik të mesëm të specialiteteve të ndryshme;  Teknik armatimi;  Kujdestar – magazinier (për armatime dhe të tjera);  Përgjegjës i godinave të shtëpive të pushimit;  Teknik ndërtimi;  Fenerist detar;  Ekspeditor;  Dispeçer;  Infermier;  Kuzhinier;  Fotograf;  Fotoreporter;  Telekronist;  Zetorist;  Operator audioviziv;  Montazhier grafist</p>	VI	
4.	<p>Operator;  Magazinier;  Shofer autoambulance;</p>	V	
5.	<p>Kartelist;</p>	IV	

	Evidencier; Inventarizues; Rrobaqepës; Kamerier; Kolaudator; Kopjues notash; Daktilografist; Fotokopjues; Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme; Punëtorë të bazave prodhuese; Shofer autoveture; Shofer automjeti transporti deri 2.5 tonë; Rojë me armë; Ftues; Furnitor; Fillrojtës		
6.	Ndihmëskuzhinier; Kaldajist; Drejtues të motoçikletave dhe motokarrove; Punonjës ngarkim-shkarkimi; Zhbllokues; Garderobier; Këpuçar; Berber	III	
7.	Lulishtar; Pjatararës; Rrobalarës; Biletashitës; Rojë pa armë; Punonjës shërbimi	II	
8.	Sanitar/pastrues; Korrier; Centralist	I	

**VENDIM**  
**Nr.552, datë 11.8.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 “PËR  
PAGAT DHE SHTESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit Pyjor”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Renditja e funksioneve organike sipas klasave të pagave, për punonjësit e drejtorive të Shërbimit Pyjor sipas kategorive, shtesa për funksion drejtues dhe shtesa për kushte të veçanta të shërbimit, përcaktohen sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

c) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me përmbajtje:

“5/1. Punonjësit e Shërbimit Pyjor, përfitojnë shtesë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas përcaktimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore. ” .

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave për vitin 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 korrik 2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

#### STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PYJOR

<b>Nr.</b>	<b>Klasa</b>	<b>Paga bazë mujore në lekë</b>
1.	I	20000
2.	II	20100
3.	III	20300
4.	IV	20500
5.	V	20700
6.	VI	21000
7.	VII	21990
8.	VIII	23000
9.	IX	23570
10.	X	24670
11.	XI	25700
12.	XII	26300
13.	XIII	26800
14.	XIV	27900
15.	XV	30000
16.	XVI	31060
17.	XVII	32700
18.	XVIII	33800
19.	XIX	34300
20.	XX	35350
21.	XXI	37500
22.	XXII	38600
	XXIII	40700

**RENDITJA E FUNKSIONEVE ORGANIKE SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORIVE TË SHËRBIMIT PYJOR**

Nr.	Funksioni	Kategoria		Klasa	Shtesa për funksion drejtues		Shtesa për kushte të veçanta shërbimi	
		I	II		Grupi	Përqindja	I	II
1	Drejtor	I		XXIII	6	40		
	Drejtor		II	XXII	6	40		
2	Shef i Policisë Pyjore	I		XXI	5	30		
	Shef seksioni i Policisë Pyjore		II	XX	5	30		
3	Shef seksioni	I		XXI	4	15		
	Shef seksioni		II	XX	4	15		
4	Inspektor i Policisë Pyjore në seksion	I		XIX			15	10
	Inspektor i Policisë Pyjore në seksion		II	XVIII				10
5	Specialist (inspektor në seksion)	I		XIX			5	
	Specialist (inspektor në seksion)		II	XVIII				5
6	Përgjegjës sektori i zonave të mbrojtura	I	II	XVII	3	10	15	15
	Specialist në zonat mbrojtura	I	II	XVI			10	10
	Inspektor në zonat mbrojtura me arsim të lartë	I	II	XVI			20	20
	Inspektor në zonat e mbrojtura me arsim të mesëm	I	II	XV			20	20
	Përgjegjës i rojeve mjedisore	I		XVI	3	10	10	
	Rojë mjedisore (i lartë)	I		XIV			15	
	Rojë mjedisore (i mesëm)	I		XIII			15	
	Përgjegjës sektori	I		XVI	3	10		
	Përgjegjës sektori		II	XV	3	10		
	Inspektor i pyjeve (arsim i lartë)	I	II	XIV			10	10
	Inspektor i pyjeve (arsim i mesëm)	I	II	XIII			10	10
	Punonjës administrate	I	II	X				
	Arkivist /protokollist	I	II	X				
	Vrojtues i përhershëm	I	I	IX				
	Vrojtues provizor	I	II	VII				
	Shofer	I	II	VI			10	10
	Rojë	I	II	IV				

Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, drejtori të shërbimit pyjor të kategorisë së parë dhe të dytë do të konsiderohen si më poshtë:

**Kategoria e parë:**

Berat, Bulqizë, Durrës, Dibër, Devoll, Elbasan, Gramsh, Gjirokastrë, Korçë, Kolonjë Kukës, Librazhd, Mat, Mirditë, Malësi e Madhe, Pukë, Përmet, Pogradec, Skrapar, Shkodër, Tropojë, Tiranë, Vlorë.

**Kategoria e dytë:**

Delvinë, Fier, Has, Kavajë, Kuçovë, Krujë, Lushnjë, Lezhë, Laç, Mallakastër Peqin, Sarandë Tepelenë.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 11.8.2011  
Doli nga shtypi më 12.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë